



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 23 mars 2023
Kodi i ZRRE-së: V_1711_2023

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke u bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Neni 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, Neni 25, Neni 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 28, Paragrafi 1.27 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Dispozitat e Nenit 10 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes,
- Dispozitat e Nenit 1, paragrafit 3 të Rregullës për Vlerësimin e Projekteve Kapitale në Rrjetin e Transmetimit dhe Shpërndarjes në Sektorin e Energjisë Elektrike,
- Dispozitat e Nenit 2, paragrafit 2 si dhe dispozitat e Nenit 6 të Shtojcës 3 të Rregullës për Të Hyrat e OSSH-së,
- Kërkesën e OSSH-së, të datës 20.03.2023 për shqyrtim dhe aprovim të Planit Zhvillimor dhe Investues pesë (5) vjeçar i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes 2023 – 2027,

në seancën e mbajtur me datë 23 mars 2023 nxori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET** - Planit Zhvillimor dhe Investues pesëvjeçar i Shpërndarjes 2023 – 2027.
- II. OBLIGOHET** – Operatori i Sistemit të Shpërndarjes KEDS SH.A, që të zbatoj projektet e planifikuara sipas këtij plani për funksionimin më të sigurt të Sistemit të Shpërndarjes.

A r s y e t i m

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 01.06.2022 ka pranuar kërkesën për shqyrtim dhe aprovim të Planit Investues pesë (5) vjeçar të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes 2023 – 2027 të OSSH-së.
- o ZRRE pas shqyrtimit fillestar të Planit Zhvillimor dhe Investiv pesë (5) vjeçar të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes 2023 – 2027, ka dhënë komentet fillestare, të cilat me datë 08.07.2022 i ka dërguar tek OSSH.
- o ZRRE ka trajtuar Planin zhvillimor dhe Planin Investiv si një dokument të titulluar si “Planit



Zhvillimor dhe Investues pesë (5) vjeçar i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes 2023 – 2027”, duke marr parasysh që periudha që përfshinë Planin Zhvillimor Pesë (5) vjeçar ka koiciduar të jetë e njëjtë me Periudhën e Tretë Rregullative (2023-2027).

- OSSH më datë 05.09.2022 ka dërguar Planin Zhvillimor dhe Investues pesë (5) vjeçar të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes 2023 – 2027 të reviduar.
- ZRRE pas analizimit të Planin Zhvillimor dhe Investues pesë (5) vjeçar të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes 2023 – 2027 më datë 18.11.2022, ka dërguar komentet plotësuese duke u bazuar në identifikimin e nevojave shtesë të evidentuara nga ZRRE që OSSH duhet të i dërgojë me qëllim të përfundimit të Planit zhvillimor dhe Investues pesëvjeçar të OSSH-së 2023 - 2027.
- OSSH më datë 30.11.2022, ka dërguar Planin Zhvillimor dhe Investues pesë (5) vjeçar të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes 2023 – 2027 të reviduar pas komenteve plotësuese të ZRRE-së.
- ZRRE me datë 05.12.2022, ka publikuar Planin Zhvillimor dhe Investues për diskutim publik për të pranuar komente sugjerime dhe vlerësime si nga të licencuarat po ashtu edhe nga palët e interesit.
- Pas përfundimit të konsultimit publik, dhe pas takimeve të shumta me KEDS dhe pas përfshirjes së komenteve të ZRRE-së, OSSH me datë 20.03.2023 ka dërguar dokumentin final për miratim në ZRRE, me ndryshimet e kërkuara nga ZRRE.
- Vlen të theksohet se në vlerësimin e projekteve kapitale që duhet të përshihen në Planin Pesëvjeçar Investues 2023 - 2027, ZRRE ka aplikuar një renditje prioritare të projekteve dhe programeve të bazuar në faktorët e prioritizimit të dakorduar ndërmjet OSSH dhe ZRRE. Plani i komisionimit të projekteve kapitale 2023-2027 është bërë duke u bazuar në klasifikimin dhe kategorizimin e projekteve nëpër kategori të aseteve të bazuar në kostot që kanë rezultuar sipas lejimit të ZRRE-së, ashtu që vlera nëpër kategori të caktuara të aseteve dhe nëpër vite të jetë e saktë.
- Gjithashtu vlen të theksohet se për projektet kapitale për të cilat ZRRE nuk ka pasur informata, vlerësimi është bërë bazuar në të dhënat që OSSH ka ofruar. Projektet e tilla janë projektet që kanë të bëjnë me kalimin 10-20kV, ku nga 47.9mil€ të kërkuara nga OSSH, ZRRE ka njohur kostot në vlerë prej 45.9mil€. Gjithsesi, ZRRE nuk ka hequr projektet e kërkuara, por vetëm në vlerësimin e kostove për njësi ka hequr astetet/transformatorët për të cilët OSSH nuk ka pasur informata.
- Për më tepër dallimet e theksuara ndërmjet projekteve të kërkuara nga OSSH dhe të njohura nga ZRRE kanë të bëjnë me projektet njehsorëve, investimet në tensionin e ultë në vitet 2026-2027



dhe lidhjet e reja. Lidhur me njehsorët, ZRRE vlerësimin e saj e ka bazuar në dinamikën e investimeve të realizuara në PRR 1 dhe PRR 2, numrin e njehsorëve të instaluar në këto dy periudha, numrin e njehsorëve mekanik, etj. Megjithatë pas konsultimeve me OSSH, për vitin 2023 kostot e njehsorëve janë rishikuar nga 3 mil€ në 4 mil€. Sidoqoftë, për vitet në vijim ZRRE ka kërkuar nga OSSH të përpilojë studim të detajuar fizibiliteti duke u bazuar në rezultatet e vitit 2023 për të evidentuar nevojat e investimeve në të ardhmen që kanë të bëjnë me njehsorë.

- ZRRE për kategorinë e projekteve në Tension të Ultë, bazuar në numrin e madh të projekteve të bartura nga PRR2, proceset administrative që kanë të bëjnë me tenderim, realizimet në periudhat paraprake, nuk sugjeron se OSSH mund të ketë dinamikën e implementimit të projekteve në PRR3 dukshëm të ndryshme se ajo në PRR 1 dhe PRR 2.
- ZRRE ashtu siç ka sqaruar se për kostot e projekteve që kanë të bëjnë me lidhjet e reja, ato nuk duhet të përfshihen në tarifa, ngase për këtë qëllim janë rishikuar Parimet për Përcaktimin e Tarifave për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes, ndërsa dokumenti Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Shpërndarjes duhet të jetë në harmoni me ato. Derisa, kostot për lidhjet e reja e për të cilat OSSH mund të ketë shkaktuar ato do të trajtohen nga ZRRE.
- ZRRE ka kërkuar nga OSSH që në vlerësimin e projekteve kapitale për periudhën pesë (5) vjeçare informata për burimet e financimit të këtyre projekteve. Nga informatat e pranuar, OSSH nuk ka ndonjë marrëveshje kredie për financimin e projekteve të planifikuara në PRR3, prandaj ZRRE ka sugjeruar se projektet dhe programet investive që duhet të përfshihen në Planin Zhvillimor Pesë (5) vjeçar të jenë në harmoni me atë Investiv Pesë (5) vjeçar.
- ZRRE thekson se bazuar në Rregullat për të Hyrat OSSH-së, OSSH mund të aplikojë në çdo kohë, për të zëvendësuar një projekt kapital në planin e aprovuar të investimi, t me ndonjë projekt tjetër kapital, në rastet kur mund të dëshmohet se projekti alternativ do të sjellë përfitime të njëjta apo më të mira për konsumatorët se projekti fillestar (duke marrë parasysh rezultatet e pritura dhe kostot). Nëse rregullatori e aprovon zëvendësimin, projekti alternativ do t'i shtohet bazës së aseteve të rregulluara në shqyrtimin periodik të ardhshëm.
- Bordi i ZRRE, pas vlerësimit dhe analizimit të Planin Zhvillimor dhe Investues pesë (5) vjeçar të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes 2023 – 2027 ka konstatuar që janë përmbushur kërkesat ligjore, dhe ka vlerësuar se projektet e përfshira në dokument janë të arsyeshme dhe të nevojshme për funksionimin e sigurt të sistemit të shpërndarjes, prandaj ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.



III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.


Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Shtojcë: Plani pesë (5) vjeçar Zhvillimor dhe Investues i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për periudhën 2023 – 2027.

Bordi i ZRRE-së:


Ymer Fejzullahu, Kryesues


Lutfije Dervishi, anëtar


Garri Buçaj, anëtar

Vendimi dhe dokumenti i dërgohet:

- Të licencuarit – KEDS SH.A., dhe
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji.